5. A âsht Marija nxânsja mâ e gjatë e klasës?
Po, Marija âsht nxânsja mâ e gjatë e klasës.
Kush âsht vajza mâ e gjatë e klasës?
Marija âsht vajza mâ e gjatë e klasës.

A âsht Fatimja nxânsja mâ e mirë e shkollës?
Po, Fatimja âsht nxânsja mâ e mirë e shkollës.
Kush âsht nxânsja mâ e mirë e shkollës?
Fatimja âsht nxânsja mâ e mirë e shkollës.

6. A âsht Marija mâ e gjata nxânse në shkollë?
Po, Marija âsht mâ e gjata nxânse në shkollë.
Cila âsht mâ e gjata nxânse në shkollë?
Marija âsht mâ e gjata nxânse në shkollë.

A âsht Fatimja mâ mira nxânse në klasë?
Po, Fatimja âsht mâ e mira nxânse në klasë.
Kush âsht mâ e mira nxânse në klasë?
Fatimja âsht mâ e mira nxânse në klasë.

7. A janë nxânsit tonë mâ të gjatë se mësuesit?
Po, nxânsit tonë janë mâ të gjatë se mësuesit.
Cilët janë mâ të gjatë se mësuesit?
Nxânsit tonë janë mâ të gjatë se mësuesit.

A janë mësueset tona mâ të gjata se nxânset?
Po, mësueset tona janë mâ të gjata se nxânset.
Cilat janë mâ të gjata se nxânset?
Mësueset janë mâ të gjata se nxânset.

A janë djelmt tonë mâ të mirë se djelmt tuej?
Po, djelmt tuej janë mâ të mirë se djelmt tonë.
Cilët janë mâ të mirë se djelmt tuej?
Djelmt tuej janë mâ të mirë se djelmt tonë.

8. A janë Kasemi e Gjoni mâ të zellshmit nxânës
në klasë.
Po, Kasemi e Gjoni janë mâ të zellshmit nxânës
në klasë.
Cilët janë mâ të zellshmit nxânës në klasë?
Kasemi e Gjoni janë mâ të zellshmit nxânës
në klasë.

A janë Hasani e Hyseni mâ të mirët ushtarë
në kompaní?
Po, Hasani e Hyseni janë mâ të mirët ushtarë
në kompaní.
Cilët janë mâ të mirët ushtarë në kompaní?
Hasani e Hyseni janë mâ të mirët ushtarë në
kompaní.

A janë Fatimja dhe Marija mâ të zellshmet nxânse
në klasë?
Po, Fatimja dhe Marija janë mâ të zellshmet
nxânse në klasë.
Cilat janë mâ të zellshmet nxânse në klasë?
Fatimja dhe Marija janë mâ të zellshmet nxânse
në klasë.
Cilat janë mâ të mirat nxânse në shkollë?
Fatimja dne Marija janë mâ të mirat nxânse
në shkollë.

9. A âsht Agimi mâ i zellshëm se Tefta?
Po, Agimi âsht mâ i zellshëm se Tefta.
A âsht Tefta mâ e gjatë se Agimi?
Po, Tefta âsht mâ e gjatë se Agimi.

For further drill use alternately: Skenderi-Lulja, Fatoni-Bukurija, Haxhiu-Drita.

10. A ecni ju mâ shpejt se unë?
Po, unë eci u shpejt se ju.
Kush ecën mâ shpejt se unë?
Unë eci mâ shpejt se ju.

A flitni ju tash mâ mirë se dý javë mâ parë?
Po, na flasim tash mâ mirë se dý javë mâ parë.
Si flitni ju tash?
Na flasim tash mâ mirë.

A hanë njerzit në darkë mâ shumë se në drekë?
Po, njerzit hanë darkë mâ shumë se në drekë.
Kush ha në darkë mâ shumë se në drekë?
Njerzit hanë në darkë mâ shumë se në drekë.

A do të vîni nesër mâ heret se sot?
Po, na do të vîjmë nesër mâ heret se sot.
Kur do të vîni nesër?
Na do të vîjmë nesër mâ heret se sot.

A kushton xhaketa mâ shumë se pantallonat?
Po, xhaketa kushton mâ shumë se pantallonat.
Çka kushton mâ shumë se pantallonat?
Xhaketa kushton mâ shumë se pantallonat.

A âsht universiteti mâ larg se spitali?
Po, universiteti âsht mâ larg se spitali.
Cili âsht mâ larg: universiteti apo spitali?
Universiteti âsht mâ larg.

PJESA E DYTË
DIALOGU

SECOND PART
DIALOGUE

KRYEQYTETI I SHQIPNÍS

1. Sa banorë ka Tirana?
2. Simbas regjistrimit të popullsís që u-bâ në vjetin 1958, Tirana ka 150,000 banorë.

3. Me çka merren banorët e qytetit?
4. Tirana ka përreth shumë fusha e kodra; natyrisht, në këto zona Tiranasit janë bujq.

5. Ç'punë bâjnë qytetarët?
6. Nji pjesë madhe janë nëpunës të shtetit; tjerët punojnë ndër fabrika, uzina e kombinate.

7. Cila âsht fabrika mâ e madhe në Tiranë.
8. Mâ e madhja âsht kombinati i tekstilit.

9. A âsht Tirana nji qytet i vjetër?
10. Jo. Tirana âsht qyteti mâ i rí i Shqipnís; Shkodra e Durrsi janë qytetet mâ të vjetra.

11. Çka e bân Tiranën mâ të bukur se qytetet tjera?
12. Asht nji qytet mâ modern se tjerat, ka fusha e kodra të gjelbërta dimën e verë.

13. E kam ndigjue këtë gjâ.
14. Natyrisht, si kryeqytet, ka mâ shumë gjâna se qytetet tjera të jugut e të veriut.

15. Çka ka Tirana karakteristike?
16. Ka vila të bukura, xhamí të vjetra dhe dhé të kuq.

17. Ashtu? Kjo qenka arsyeja pse Tirana quhet edhe "Tirana e Kuqe."
18. Po. Shtëpít e vjetra, të ndërtueme me qerpiçë, i apin Tiranës ngjyrën e kuqe.

19. Tirana, si kryeqytet, duhet të jetë edhe qendër intelektuale.
20. Po. Tirana ka universitet, nji institut shkencash, teatra etj.

21. Kur u-bâ Tirana kryeqytet?
22. Në vjetin 1920, tetë vjetë mbas shpalljes së pamvarësís.

LESSON XXXXI



110

PJESA E DYTË
DIALOGU

SECOND PART
DIALOGUE

Idiomatic Translation - Përkëthimi i Lirë

1. What's the population of Tirana?
2. According to the 1958 census Tirana has 150,000 inhabitants.

3. What's the main occupation of the inhabitants of the city?
4. Around Tirana there are many fields and hills, for this reason in these zones the inhabitants are farmers.

5. What's the main occupation of the city dwellers?
6. A great number are government employees; the others work in various factories.

7. Which is the largest factory in Tirana?
8. The textile mill is the largest.

9. Is Tirana an old city?
10. No. Tirana is the newest city in Albania, Shkodër and Durrës are the oldest.

11. What makes Tirana more beautiful than the other cities?
12. It's more modern than the other cities and it has fields and hills that are always green.

13. I have heard about this.
14. Naturally, as a capital city it has more things than the other cities of the North and South.

15. What are some of the characteristic things in Tirana?
16. It has beautiful villas (houses), old mosques and red soil.

17. Is that so! Then that's the reason why Tirana is also called "Red Tirana."
18. Yes. The old houses built with adobe give the city a reddish color.

19. Tirana being the capital city must also be an intellectual center.
20. Yes, Tirana has a university, an institute of sciences, theaters, etc.

21. When did Tirana become the capital city of Albania?
22. In 1920, eight years after the declaration of independence.

PJESA E TRETË
ANALIZË GRAMATIKORE

THIRD PART
GRAMMAR ANALYSIS

COMPARISON OF ADJECTIVES

Different forms of descriptive adjectives are used to indicate three degrees of comparison: positive, comparative and superlative.

The Comparative--The comparative degree of an adjective is regularly formed by placing mâ before it and se after it for inequality and by placing aq before it and sa after it for equality.

Examples:

Ylberi âsht mâ i gjatë se Kasemi.
(Ylber is taller than Kasem.)

Motra âsht mâ e madhe se unë.
(My sister is older than I.)

Këto dý pênda janë mâ të bukura se ato atje.
(These two pens are more beautiful than those over there.)

Ylberi âsht aq i gjatë sa Kasemi.
(Ylber is as tall as Kasem.)

Vajza âsht aq e gjatë sa grueja.
(The girl is as tall as the woman.)

Djelmt janë aq të gjatë sa burrat.
(The boys are as tall as the men.)

Vajzat janë aq të gjata sa grât.
(The girls are as tall as the women.)

Rule 1. The descriptive adjective agrees in gender and number with the noun it describes.

Examples:

Djali âsht mâ i gjatë se vajza.
(The boy is taller than the girl.)

Vajza âsht mâ e zellshme se djali.
(The girl is more zealous than the boy.)

Remark: If both terms of the comparison are understood, then, we may find the comparative degree expressed as follows:

mâ i gjatë, mâ i mirë, mâ e zezë, etj.

The Superlative--The superlative degree denotes the greatest or the least amount or intensity of the quality existing among all beings and objects compared.

In Albanian the superlative is formed:

(a) By placing the noun in definite form before the comparative degree.

Examples:

Ylberi âsht djali mâ i gjatë në klasë.
(Ylber is the tallest boy in class.)

Tryeza mâ e mirë âsht në dhomën tjetër.
(The best desk is in the other room.)

Djelmt mâ të gjatë në klasë janë Kasemi e Ylberi.
(The tallest boys in class are Kasem and Ylber.)

Vajzat mâ të bukura janë nga Tirana.
(The most beautiful girls are from Tirana.)

(b) For emphasis, or to avoid repetition of the noun, the latter and the adjective may invert positions. In such a case the adjective takes the definite article.

Examples:

Ky nxânës âsht nxânsi mâ i mirë.
(This is the best student.)

Marija âsht vajza mâ e bukur e qytetit.
(Mary is the prettiest girl in town.)

The above examples may be expressed as follows:

Ky nxânës âsht mâ i miri nxânës or
Ky nxânës âsht mâ i miri.

Marija âsht mâ e bukura vajzë e qytetit or
Marija âsht mâ e bukura e qytetit.

Këta dy nxânës janë mâ të mirët në klasë.

COMPARISON WITH ADVERBS

Actions of persons, animals or actions attributed to growing and living things, may be expressed in terms of intensity of the actions performed.

In Albanian such degree of intensity is expressed by mâ plus adverb, se, noun, for inequality, aq, adverb sa, noun for equality.

Examples:

Unë eci mâ shpejt se mësuesi.
(I walk faster than the teacher.)

Mësuesi shkruen mâ mirë se nxânsi.
(The teacher writes better than the pupil.)

Qeni ha mâ shumë se maca.
(The dog eats more than the cat.)

Unë ha aq sa ti.
(I eat as much as you.)

Unë flas shqip aq mirë sa flet ti.
(I speak Albanian as good as you do.)

XXXXI

PJESA E KATËRTË
USHTRIME GRAMATIKORE

FOURTH PART
GRAMMAR DRILL

1. A âsht ky mâ i mirë se ai?
Po, ky âsht mâ i mirë se ai.
Kush âsht mâ i mirë se ai?
Ky âsht mâ i mirë se ai.
Qysh âsht ky?
Ky âsht mâ i mirë se ai.

A âsht kjo mâ e mirë se ajo?
Po, kjo âsht mâ e mirë se ajo.
Kush âsht mâ e mirë se ajo?
Kjo âsht mâ e mirë se ajo.
Qysh âsht kjo?
Kjo âsht mâ e mirë se ajo.

A janë këta mâ të mirë se ata?
Po, këta janë mâ të mirë se ata.
Cilët janë mâ të mirë se ata?
Këta janë mâ të mirë se ata.
Qysh janë këta?
Këta janë mâ të mirë se ata.

A janë këto mâ të mira se ato?
Po, këto janë mâ të mira se ato.
Cilat janë mâ të mira se ato?
Këto janë mâ të mira se ato.
Qysh janë këto?
Këto janë mâ të mira se ato.

2. A âsht ky libri mâ i mirë që keni?
Po, ai âsht libri mâ i mirë që kam.
Cili âsht libri mâ i mirë që keni?
Ai âsht libri mâ i mirë që kam.
Cili libër âsht ky?
Ky âsht libri mâ i mirë që kam.

A âsht kjo ndërtesa mâ e bukur e qytetit?
Po, ajo âsht ndërtesa mâ e bukur e qytetit.
Cila âsht ndërtesa mâ e bukur e qytetit.
Ajo âsht ndërtesa mâ e bukur e qytetit.
Cila ndërtesë âsht kjo?
Ajo âsht ndërtesa mâ e bukur e qytetit.

A janë këta nxânsit mâ të mirë të klasës?
Po, këta janë nxânsit mâ të mirë të klasës.
Cilët janë nxânsit mâ të mirë të klasës?
Këta janë nxânsit mâ të mirë të klasës.
Cilët nxânës janë këta?
Këta janë nxânsit mâ të mirë të klasës.

A janë këto rrugët mâ të gjâna të qytetit?
Po, këto janë rrugët mâ të gjâna të qytetit.
Cilat janë rrugët mâ të gjâna të qytetit?
Këto janë rrugët mâ të gjâna të qytetit.
Cilat rrugë janë këto?
Këto janë rrugët mâ të gjâna të qytetit.

3. A âsht ky mâ i gjati i nxânësvet?
Po, ai âsht mâ i gjati i nxânësvet.
Kush âsht mâ i gjati i nxânësvet?
Ai âsht mâ i gjati i nxânësvet.
Kush âsht ky?
Ai âsht mâ i gjati i nxânësvet.

A âsht ajo mâ e bukura e shkollës?
Po, ajo âsht mâ e bukura e shkollës.
Kush âsht mâ e bukura e shkollës?
Ajo âsht mâ e bukura e shkollës.
Kush âsht ajo?
Ajo âsht mâ e bukura e shkollës.

A janë këta mâ të zellshmit e klasës?
Po, këta janë mâ të zellshmit e klasës.
Cilët janë mâ të zellshmit e klasës?
Këta janë mâ të zellshmit e klasës.
Cilët janë këta?
Këta janë mâ të zellshmit e klasës.

A janë këto mâ të shtrêjtat që keni?
Po, këto janë mâ të shtrêjtat që kemi.
Cilat janë mâ të shtrêjtat që keni?
Këto janë mâ të shtrêjtat që kemi.
Cilat janë këto?
Këto janë mâ të shtrêjtat që kemi.

4. A shkova sot në shkollë më heret se dje?
Po, sot ju shkuet në shkollë më heret se dje.
Kush shkoi sot në shkollë më heret se dje?
Ju shkuet sot në shkollë më heret se dje.
Ku shkova unë sot më heret se dje?
Ju shkuet sot në shkollë më heret se dje.
Çka bâna sot më heret se dje?
Ju shkuet sot në shkollë më heret se dje.
Kur shkova në shkollë më heret se dje?
Sot ju shkuet në shkollë më heret se dje.

A punojnë disa njerëz më shumë në verë se në dimën?
Po, disa njerëz punojnë më shumë në verë se në dimën.
Cilët punojnë më shumë në verë se në dimën?
Disa njerëz punojnë më shumë në verë se në dimën.
Çka bâjnë disa njerëz në verë më shumë se në dimën?
Disa njerëz punojnë në verë më shumë se në dimën.
Kur punojnë disa njerëz më shumë se në dimën?
Disa njerëz punojnë më shumë në verë se në dimën.

A çohem të dielen më vonë se ditët tjera?
Po, të dielen ju çoheni më vonë se ditët tjera.
Kush çohet të dielen më vonë se ditët tjera?
Ju çoheni të dielen më vonë se ditët tjera.
Kur çohem unë më vonë se ditët tjera?
Të dielen ju çoheni më vonë se ditët tjera.
Çka bâj unë të dielen?
Ju çoheni të dielen më vonë se ditët tjera.

A flet ai spanisht më mirë se ju?
Po, ai flet spanisht më mirë se unë.
Kush flet spanisht më mirë se ju?
Ai flet spanisht më mirë se unë.
Ç'gjuhë flet ai më mirë se ju?
Ai flet spanisht më mirë se unë.
Qysh flet ai spanisht?
Ai flet spanisht më mirë se unë.

5. A âsht Zotni Kashari tiranas?
Po, Zotni Kashari âsht tiranas.
Kush âsht tiranas?
Zotni Kashari âsht tiranas.
Prej nga âsht Zotni Kashari?
Zotni Kashari âsht tiranas.

A âsht Zoja Kashari tiranase?
Po, Zoja Kashari âsht tiranase.
Kush âsht tiranase?
Zoja Kashari âsht tiranase.
Prej nga âsht Zoja Kashari?
Zoja Kashari âsht tiranase.

A âsht Zotní Kalaja durrsak?
Po, Zotrí Kalaja âsht durrsak.
Kush âsht durrsak?
Zotní Kalaja âsht durrsak.
Po Zoja Kalaja, a âsht durrsake?
Jo, Zoja Kalaja âsht dibrane.

A âsht Zotní Gurakuqi shkodran?
Po, Zotní Gurakuqi âsht shkodran.
Kush âsht shkodran?
Zotní Gurakuqi âsht shkodran.
Po Zoja Gurakuqi, a âsht shkodrane?
Jo, Zoja Gurakuqi âsht beratase.

A âsht Zotní Lubonja korçár?
Po, Zotní Lubonja âsht korçár.
Kush âsht korçár?
Zotní Lubonja âsht korçár.
Po Zoja Lubonja, prej nga âsht?
Zoja Lubonja âsht elbasanase.

A âsht Zotní Pëllumbi gjinokastrit?
Po, Zotní Pëllumbi âsht gjinokastrit.
Kush âsht gjinokastrit?
Zotní Pëllumbi âsht gjinokastrit.
Prej nga âsht Zotní Pëllumbi?
Zotní Pëllumbi âsht gjinokastrit.
Po Zoja Pëllumbi, a âsht gjinokastrite?
Jo, Zoja Pëllumbi âsht korçare.

A âsht Zotní Çela vlonjat?
Po, Zotní Çela âsht vlonjat.
Kush âsht vlonjat?
Zotní Çela âsht vlonjat.
Prej nga âsht Zotní Çela?
Zotní Çela âsht vlonjat.
Po Zoja Çela, a âsht vlonjate?
Jo, Zoja Çela âsht kosovare.

6. A ka pemë përreth ndërtesës?
Po, përreth ndërtesës ka pemë.
Çka ka përreth ndërtesës?
Përreth ndërtesës ka pemë.
Ku ka pemë?
Përreth ndërtesës ka pemë.

A âsht Zotní Rruga katundár apo qytetár?
Zotní Rruga âsht qytetár.
Kush âsht qytetár?
Zotní Rruga âsht qytetár.
Çka âsht Zotní Rruga?
Zotní Rruga âsht qytetár.

A âsht Zotní Bilali nëpunës në Shoqnín S.T.A.?
Po, Zotní Bilali âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.
Kush âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.?
Zotní Bilali âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.
Çka âsht Zotní Bilali në Shoqnín S.T.A.?
Zotní Bilali âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.
Ku âsht nëpunës Zotní Bilali?
Zotní Bilali âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.
Në cilën shoqní âsht nëpunës Zotní Bilali?
Zotní Bilali âsht nëpunës në Shoqnín S.T.A.

A punon baba i tij n'Uzinën 28 Nânduer?
Po, baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.
Kush punon n'Uzinën 28 Nânduer?
Baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.
Ku punon baba i tij?
Baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.
Baba i kujt punon n'Uzinën 28 Nânduer?
Baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.
Në cilën uzinë punon baba i tij?
Baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.
Çka bân baba i tij n'Uzinën 28 Nânduer?
Baba i tij punon n'Uzinën 28 Nânduer.

7. A âsht San Francisco-ja nji qytet modern?
Po, San Francisco-ja âsht nji qytet modern.
Cili qytet âsht mjaft modern?
San Francisco-ja âsht nji qytet njaft modern.
Çfarë qyteti âsht San Francisco-ja?
San Francisco-ja âsht nji qytet mjaft modern.

A janë të gjelbërta pemët në verë?
Po, në verë pemët janë të gjelbërta.
Qysh janë pemët në verë?
Në verë pemët janë të gjelbërta.
Kur janë pemët të gjelbërta?
Në verë pemët janë të gjelbërta.
Cfarë ngjyre janë pemët në verë?
Në verë pemët janë të gjelbërta.

A keni hŷ ndonjiherë në nji xhamí?
Po, unë kam hŷ disa herë në xhamí.
Kush ka hŷ disa herë në xhamí?
Unë kam hŷ disa herë në xhamí.
Sa herë keni hŷ në xhamí?
Unë kam hŷ disa herë në xhamí.
Ku keni hŷ disa herë?
Unë kam hŷ disa herë në xhamí.

A âsht i mirë ky dhé për të mbjellë zarzavate?
Po, ky dhé âsht shumë i mirë për të mbjellë zarzavate.
Cili dhé âsht shumë i mirë për të mbjellë zarzavate?
Ky dhé âsht shumë i mirë për të mbjellë zarzavate.
Për çka âsht i mirë ky dhé?
Ky dhé âsht shumë i mirë për të mbjellë zarzavate.
Qysh âsht ky dhé për të mbjellë zarzavate?
Ky dhé âsht shumë i mirë për të mbjellë zarzavate.

A âsht e ndërtueme shtëpija e tij me qerpiçë?
Po, shtëpija e tij âsht e ndërtueme me qerpiçë.
Shtëpija e kujt âsht e ndërtueme me qerpiçë?
Shtëpija e tij âsht e ndërtueme me qerpiçë.
Cila shtëpí âsht e ndërtueme me qerpiçë?
Shtëpija e tij âsht e ndërtueme me qerpiçë.
Me çka âsht e ndërtueme shtëpija e tij?
Shtëpija e tij âsht e ndërtueme me qerpiçë.

A janë të bukura ndërtesat e Universitetit të Shtetit në Tiranë?
Po, ndërtesat e Universitetit të Shtetit në Tiranë janë të bukura.

Si janë ndërtesat e Universitetit të Shtetit
në Tiranë?
Ndërtesat e Universitetit të Shtetit në Tiranë
janë të bukura.
Cilat ndërtesa janë të bukura?
Ndërtesat e Universitetit të Shtetit në Tiranë
janë të bukura.
Ndërtesat e cilit universitet janë të bukura?
Ndërtesat e Universitetit të Shtetit në Tiranë
janë të bukura.

XXXXI

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

FIFTH PART
TRANSLATION EXERCISE

Në vendin tim âsht zakon (custom) që njerzit të veshen për Pashkë me plaçka të reja: këpucë, çorapë, këmishë, kapelë dhe gjithëçka tjetër do të veshin at ditë. Mbasi të dielen që vjen janë Pashkët, ca ditë mâ parë shkova me blé nji palë rrobe. M'u-desh me shkue në shumë dyqane derisa gjeta kostumin që kërkojshem. Nuk qe nji gjâ e lehtë sepse ca nuk më bijshin, ca nuk më rrijshin mirë dhe ca tjera kushtojshin shumë. Mâ i miri që pashë në nji dyqan ishte nji kostum shumë elegant, i bâmë n'Anglí. Siç dihet, Anglija prodhon stofnat (fabrics) mâ të mira që mund të mendoni.

Pashkët në Shqipní janë nji ndër festat mâ të mëdhaja. Gjatë trí ditëve të Pashkëvet-kaq ditë kanë qenë festue mâ parë-burrat e grât shkojnë me u bâ vizita miqvet të tyne. Kur mbarojnë vizitën njerzit e shtëpís u apin këtyne vé të kuqe që kanë pregatitë t'êjten; kjo e êjte quhet "e Ejtja e Madhe."

1. This dictionary is not good; don't you have a better one?

   No, that one is the best I have.

2. Good books are our best friends.

3. Are you feeling better today?

4. The wine we drank at my sister's house was very bad; it was worse than this.

5. Do you wake up early in the morning?

   Not very early now, but in summer I wake up much earlier than in winter.

6. We go to the library more often than you do; we go about twice a week.

7. Here are my suitcases; which one is heavier?

8. This dialogue is more difficult than that one, but the most difficult one we had was one week ago.

9. Today is the most beautiful day we have had so far.

10. This is the best coffee you can buy here.

11. The worst thing you can do when you have a cold is to go out when the weather is not good.

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

SIXTH PART
READING TEXT

Proverb: Bâne të mirën e hudhe në dét;
në mos e di peshku, e di Zoti vetë.

Tirana âsht kryeqyteti i Shqipnís. Simbas regjistrimit të popullsís që u-bâ në vjetin 1958, Tirana ka 150,000 banorë. Tirana gjindet në nji fushë dhe ka përreth kodra që janë të gjelbërta dimën e verë. Banorët e rrethevet merren me bujqësí, kurse banorët e kryeqytetit janë nëpunës të shtetit ase punojnë ndër fabrika, uzina, kombinate etj. Fabrika mâ e madhe në Tiranë âsht kombinati i tekstilit me nja 5,000 punëtorë. Tirana âsht qyteti mâ i rí i Shqipnís dhe u-bâ kryeqytet në vjetin 1920 Asht nji qytet modern me ndërtesa të mëdhaja, me vila të bukura e me rrugë të gjâna. Tirana âsht edhe qendra intelektuale e Shqipnís. Këtu gjinden: universiteti, institute të ndryshme, teatra, muzé, opera etj.

QUESTIONS - PYETJE

1. Cili âsht kryeqyteti i Shqipnís?
2. Në ç'vjet u-bâ regjistrimi i fundit i popullsís?
3. Sa banorë ka Tirana, simbas regjistrimit të fundit të popullsís?
4. Ku gjindet Tirana?

5. Çfarë kodrash ka përreth?

6. Kur janë të gjelbërta kodrat që Tirana ka përreth?

7. Me çka merren banorët e rrethevet?

8. Cilët banorë merren me bujqësi?

9. Me çka merren banorët e kryeqytetit?

10. Cilët janë nëpunës të shtetit ase punojnë ndër fabrika, uzina, kombinate etj.?

11. Ku punojnë banorët e kryeqytetit?

12. Cila âsht fabrika mâ e madhe në Tiranë?

13. Sa punëtorë ka kombinati i tekstilit?

14. Cila fabrikë ka nja 5,000 punëtorë?

15. Cili âsht qyteti mâ i rí i Shqipnís?

16. Kur u-bâ Tirana kryeqytet?

17. Cili âsht nji qytet modern?

18. Cili qytet ka ndërtesa të mëdhaja, vila të bukura e rrugë të gjâna?

19. Çka ka Tirana?

20. Cila âsht qendra intelektuale e Shqipnís?

21. Ku gjinden institute të ndryshme, muzé, teatra, opera etj.?

22. Në cilin qytet gjindet Universiteti i Shtetit?

XXXXI

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

SEVENTH PART
HOMEWORK

Translate into Albanian:

1. The textile mill in Tirana produces cloth (stofna) and is the largest factory in Albania.

2. Do you have a larger cup?
   No, that is the largest I have.

3. The tallest building in the United States is in New York.

4. Each day the children eat less than before, but eat more often.

5. Better late than never.

6. Albania has more mosques in the north than in in the south.

7. Why don't you walk a little faster? I don't want to get there (arrive) later than the other people.

8. Ylber and Skender are the best students in class.

PJESA E TETË
FJALORI

EIGHTH PART
VOCABULARY

banor, -i banorë, -t	(m.)	inhabitant
dhé, -u dhena, -t	(m.)	dirt, soil, ground, earth, lands (the only meaning which may have the pl.)
i, e, të gjelbërt të gjelbërta	(adj. m. & f.)	green
institut, -i institute	(m.)	institute
intelektual, -e intelektualë	(adj. m.&f.)	intellectual
jug, -u	(m.)	south
kombinat, -i kombinate, -t	(m.)	group of plants or factories of diff. processes but manufacturing related products, large complex factory
kombinati i tekstilit		the textile mill
i, të kuq e, të kuqe	(adj. m.&f.)	red
mijë, -a mijë, -t mija, -t	(f.)	thousand
modern, -e modernë	(adj. m.&f.)	modern
muzé, muzeu muzé, -t	(m.)	museum
i, të ndërtuem e, të ndërtueme	(adj. m.&f.)	built

nëpunës, -i nëpunës,-it	(m.)	employee, clerk
opera opera, -t	(f.)	opera, opera house
pamvarësí, -ja	(f.)	independence
përreth	(adv.)	round about
popullsí, -ja popullsí, -t	(f.)	population
qerpiç, -i qerpiçë, -t	(m.)	adobe (brick)
qytetár, -i qytetarë, -t	(m.)	city dweller, townsman, citizen
regjistrim, -i regjistrime, -t	(m.)	registration
regjistrim i popullsís		census
rreth, -i rrethe, -t	(m.)	circle, district, region, surrounding(s)
shkencë, -a shkenca, -t	(f.)	science
shpallje, -a shpallje, -t	(f.)	announcement, proclamation, declaration
tekstil, -i tekstile, -t	(m.)	textile
tiranas, -i tiranas, -it	(m.)	the native of Tirana
universitet, -i universitete, -t	(m.)	university

uzinë, -a uzina, -t	(f.)	mill (steel), officinal, large workshop
verí, -u	(m.)	north
vilë, -a vila, -t	(f.)	villa
zonë, -a zona, -t	(f.)	zone
xhamí, -ja xhamí, -t	(f.)	mosque

- Paske nji dynja libra!
- Janë të grues. Të gjithë trajtojnë nji temë të vetme: si me rritë qejt.



Gëzohem shumë që more lejen e shoferit. Tash merre këtë hartë! Të kam shenue të gjitha spitalet e ambulancat.

PJESA E PARË FIRST PART
USHTRIMË GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. A ndjek ti ndonji shkollë?
Po, unë ndjek Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet.
Kush e ndjek Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet?
Ai e ndjek Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet.
Cilën shkollë ndiqni ju?
Na ndjekim Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet.
Po ata, a e ndjekin Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet?
Po, edhe ata e ndjekin Shkollën Ushtarake të Gjuhëvet.

2. A ndoqe ndonji shkollë kur ishe n'Europë?
Jo, kur ishem n'Europë nuk ndoqa ndonji shkollë.
Kush nuk ndoqi ndonji shkollë kur ishte n'Europë?
Ai nuk ndoqi ndonji shkollë kur ishte n'Europë.
Çka nuk ndoqët ju kur ishi n'Europë?
Na nuk ndoqëm ndonji shkollë kur ishim n'Europë.
Po ata, a ndoqën ndonji shkollë kur ishin n'Europë?
Jo, as ata nuk ndoqën ndonji shkollë kur ishin n'Europë.

3. A i sjell ti librat me vete çdo mëngjes?
Po, unë i sjell librat me vete çdo mëngjes.
A e sjell mësuesi librin me vete çdo mëngjes?
Po, mësuesi e sjell librin me vete çdo mëngjes.
Çka sillni ju me vete çdo mëngjes?
Na sjellim librat me vete çdo mëngjes.
Po nxânsit tjerë, a i sjellin librat me vete çdo mëngjes?
Po, edhe nxânsit tjerë i sjellin librat me vete çdo mëngjes.

A i sjell ti librat në bibliotekë mbasi i lexon?
Po, mbasi i lexoj unë i sjell librat në bibliotekë.
Kush i sjell librat në bibliotekë mbasi i lexon?
Ai i sjell librat në bibliotekë mbasi i lexon.
Çka sillni ju në bibliotekë mbasi i lexoni?
Na i sjellim librat në bibliotekë mbasi i lexojmë.
Kur i sjellin ata librat në bibliotekë?
Ata i sjellin librat në bibliotekë mbasi i lexojnë.

4. A i solle ti të hollat me vete?
Po, unë i solla të hollat me vete.
Kush i solli të hollat me vete?
Ai i soli të hollat me vete.
Çka sollët ju me vete?
Na i sollëm të hollat me vete.
Cilët i sollën të hollat me vete?
Ata i sollën të hollat me vete.

A i a solle ti rrobet rrobaqepsit?
Po, unë i a solla rrobet rrobaqepsit.
Kush i a solli rrobet rrobaqepsit?
Ai i a solli rrobet rrobaqepsit.
Çka i sollët ju rrobaqepsit?
Na i a sollëm rrobet rrobaqepsit.
Po ata, a i a sollën rrobet rrobaqepsit?
Po, edhe ata i a sollën rrobet rrobaqepsit.

5. A do të rrijsh në qytet deri n'orën shtatë?
Po, unë do të rrij në qytet deri n'orën shtatë.
Kush do të rrijë në qytet deri n'orën shtatë?
Ai do të rrijë në qytet deri n'orën shtatë.
Ku do të rrini ju deri n'orën shtatë?
Na do të rrijmë në qytet deri n'orën shtatë.
Çka do të bâjnë ata deri n'orën shtatë?
Ata do të rrijnë në qytet deri n'orën shtatë.

A do me ardhë me mue deri në bibliotekë?
Po, unë due me ardhë me jú deri në bibliotekë.
Kush do me ardhë me jú deri në bibliotekë?
Ai do me ardhë me mue deri në bibliotekë.
Deri ku doni me ardhë me mue?
Na duem me ardhë me jú deri në bibliotekë.
Cilët duen me ardhë me jú deri në bibliotekë?
Ata duen me ardhë me mue deri në bibliotekë.

A të pëlqen gjella me shumë krypë?
Jo, mue nuk më pëlqen gjella me shumë krypë.
Kujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë?
Kurrkujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë.
Çkâ nuk ju pëlqen jú?
Né nuk na pëlqen gjella me shumë krypë.
Cilëve nuk u pëlqen gjella me shumë krypë?
Atyne nuk u pëlqen gjella me shumë krypë.

A ke nevojë sonte të shkojsh në qytet?
Po, sonte kam nevojë të shkoj në qytet.
Kush ka nevojë sonte të shkojë në qytet?
Ai ka nevojë sonte të shkojë në qytet.
Çka keni nevojë të bâni ju sonte?
Sonte na kemi nevojë të shkojmë në qytet.
Cilët kanë nevojë të shkojnë sonte në qytet?
Ata kanë nevojë sonte të shkojnë në qytet.

A qe e mundun me ardhë me automobil në shkollë?
Jo, nuk qe e mundun me ardhë me automobil në shkollë.
Çka nuk qe e mundun me bâ?
Nuk qe e mundun me ardhë me automobil në shkollë.
Me çka nuk qe e mundun me ardhë në shkollë?
Nuk qe e mundun me ardhë me automobil në shkollë.
Ku nuk qe e mundun me ardhë me automobil?
Nuk qe e mundun me ardhë me automobil në shkollë.

A shkoni në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe?
Po, n'orën dhetë unë shkoj në kafe me pí nji kafe.
Kush shkon n'orën dhetë në kafe me pí nji kafe?
Unë shkoj në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe.
Ku shkoni ju n'orën dhetë me pí nji kafe?
Unë shkoj në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe.
Në ç'orë shkoni ju në kafe me pí nji kafe?
Unë shkoj në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe.
Çka shoni me pí në kafe n'orën dhetë?
Unë shkoj në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe.
Pse shkoni në kafe n'orën dhetë?
Unë shkoj në kafe n'orën dhetë me pí nji kafe.

A ke qenë dje gjithë ditën në plazhë?
Po, dje kam qenë gjithë ditën në plazhë.
Ku keni qenë dje gjithë ditën?
Dje kam qenë gjithë ditën në plazhë.
Kush ka qenë dje gjithë ditën në plazhë?
Ai ka qenë dje gjithë ditën në plazhë.
Çka ke bâ dje gjithë ditën?
Dje kam qenë gjithë ditën në plazhë.
Kur keni qenë në plazhë?
Dje kam qenë gjithë ditën në plazhë.

PJESA E DYTË
DIALOGU

SECOND PART
DIALOGUE

KE DENTISTI

1. Ku keni qenë gjithë mëngjesin?
2. Ah, mos pyetni ku kam qenë.

3. Pse e mbani shamín para gojës?
4. Po më dhemb që mos e pyet.

5. Çka ju dhemb, dhâmbi? Pse nuk e hiqni?
6. Hoqa nji dhëmballë, prandej po më dhemb.

7. Pse e hoqët, a nuk qe e mundun me e mbushë?
8. Unë nuk desha me e hjekë, por dentisti tha se ishte prishë tepër.

9. A ju dhimti kur ju a nxori?
10. Kur m'a nxori nuk ndjeva asgjâ, por tash po e ndiej dhimbën.

11. A âsht tue ju rrjedhë gjak?
12. Besa po: në mish të dhâmbëvet kam nji vrimë sa nji shpellë!

13. Shpërlanie gojën me ujë të krypun.
14. Çfarë dobije sjell uji i krypun?

15. Krypa e ndal gjakun menjiherë.
16. Do t'a provoj kur të shkoj në shtëpí.

17. S'keni nevojë me pritë derisa të shkoni në shtëpí.
18. Po ku t'a gjêj krypën dhe ku t'a shpërlâj gojën?

19. Krypë ka në kafe dhe gojën shpërlanie në nevojtore.
20. Sa krypë me shtí?

21. Shtini dý a trí lugë kafje në nji gotë ujë.
22. A jeni i sigurtë se krypa nuk djeg?

23. Ju s'patët frikë të hiqni nji dhâmb, tash keni frikë nga krypa?
24. Mirë, mirë, po shkoj.

LESSON XXXXII



PJESA E DYTË
DIALOGU

SECOND PART
DIALOGUE

Idiomatic Translation - Përkëthimi i Lirë

TO THE DENTIST

1. Where have you been all morning?
2. Oh, don't ask me where I have been.

3. Why do you keep your handkerchief in front of your mouth?
4. It's hurting me a lot.

5. What's aching, your tooth? Why don't you have it pulled out?
6. I had a tooth pulled out, that's why I'm in pain.

7. Why did you have it pulled out, wasn't it possible to have it filled?
8. I didn't want to have it pulled out, but the dentist told me that it was too decayed.

9. Did you feel any pain when he pulled it out?
10. When he pulled it out I didn't feel anything, but now I'm feeling the pain.

11. Is it bleeding?
12. Yes, indeed it is: I have a hole as big as a cave in my gum!

13. Rinse your mouth with salt water.
14. What's salt water good for?

15. Salt stops the bleeding at once.
16. I'll do that when I go home.

17. You don't have to wait until you go home.
18. Where do I find salt and where do I rinse my mouth?

19. There is salt in the coffee shop and you go rinse your mouth in the restroom.
20. How much salt shall I put in the water?

21. Put two or three teaspoons in a glass of water.
22. Are you sure that salt doesn't sting?

23. You weren't afraid to have a tooth pulled out, now you are afraid of salt.
24. All right, all right, I'll go.

PRESENT AND SIMPLE PAST OF THE FOLLOWING VERBS:

me mjelë, me sjellë, me ndie

1. Verbs ending in the infinitive mood in -jelë, -jellë, -edhë, -jerrë are conjugated like the verb me hapë, with the following exceptions:

   -je or -e change into -i in the 2nd person plural of the present tense, and into -o in all the persons of the simple past. When this occurs -rr is softened into -r.

Examples:

Infinitive	Present tense 2nd per. plural	Simple past
me mjelë (to milk)	milni	mola, mole moli, etj.
me sjellë (to bring)	sillni	solla, solle, solli, etj.
me vjedhë (to steal)	vidhni	vodha, vodhe, vodhi, etj.
me mbledhë (to gather)	mblidhni	mblodha, mblodhe, etj.
me nxjerrë (to take out)	nxirni	nxora, nxore, etj.

2. Verbs ending in the infinitive mood in -jekë and -jegë are also conjugated like the verb me hapë, with the following exceptions:

   -jek changes into -iq and -jeg into -igj in the 2nd person plural of the present tense; in the simple past -jek changes into -oq and -jeg into -ogj.

Examples:

Infinitive	2nd per. plural	Simple past
me ndjekë (to attend)	ndiqni	ndoqa, ndoqe, ndoqi, etj.
me pjekë (to bake)	piqni	poqa, poqe, poqi, etj.
me djegë (to burn)	digjni	dogja, dogje, dogji, etj.

3. Verbs ending in the infinitive mood in -ie are conjugated like the key verb me lã with the following exception: -ie changes into -je only in the singular of the simple past.

Examples:

Infinitive	Simple past
me ndie (to feel)	Sing.-ndjeva, ndjeve, ndjeu Plural.-ndiem, ndiet, ndien
me përzie (to mix)	Sing.-përzjeva, përzjeve, përzjeu Plural.-përziem, përziet, përzien

THE PREPOSITION DERI AND THE CONJUNCTION DERISA:

Deri and derisa both mean "until." While deri is followed by another preposition (followed by a noun or pronoun) or an adverb, derisa is followed always by a verb.

Examples:

Kam lexue deri në këtë faqe.
(I read until (up to) this page.)

Na duhet të presim deri nesër.
(We have to wait until tomorrow.)

XXXXII

Pritni këtu derisa të vîjë nâna.
(Wait here until mother will return.)

Ndejta në shtëpi derisa erdhi nâna.
(I stayed home until mother arrived.)

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE

FOURTH PART
GRAMMAR DRILL

1. A ndjek unë shkollën e mesme?
Po, ju ndiqni shkollën e mesme.
Cilën shkollë ndjek ti?
Unë ndjek shkollën e mesme.
Kush ndjek shkollën e mesme?
Ai ndjek shkollën e mesme.
A ndjekim na universitetin?
Po, na ndjekim universitetin.
Ç'shkollë ndiqni ju?
Na ndjekim universitetin.
Po ata, cilën shkollë ndjekin?
Edhe ata ndjekin universitetin.

A e hjek unë xhaketën kur shkoj në shtëpí?
Po, ju e hiqni xhaketën kur shkoni në shtëpí.
Çka hjek ti kur shkon në shtëpí?
Unë e hjek xhaketën kur shkoj në shtëpí.
Kush e hjek xhaketën kur shkon në shtëpí?
Ai e hjek xhaketën kur shkon në shtëpí.
A i hjekim na këmishat kur shkojmë në plazhë?
Po, na i hjekim këmishat kur shkojmë në plazhë.
Çka hiqni ju kur shkoni në plazhë?
Na i hjekim këmishat kur shkojmë në plazhë.
Po ata, çka hjekin kur shkojnë në plazhë?
Ata i hjekin rrobet kur shkojnë në plazhë.

2. A i sjell unë librat me vete në shkollë çdo ditë?
Po, ju i sillni librat me vete në shkollë çdo ditë.
Çka sjell ti me vete në shkollë çdo ditë?
Unë sjell librat me vete në shkollë çdo ditë.
Kush i sjell librat me vete në shkollë çdo ditë?
Ai i sjell librat me vete në shkollë çdo ditë.
A i sjellim na cingaret me vete çdo ditë?
Po, na i sjellim cingaret me vete çdo ditë.
Çka sillni ju me vete çdo ditë?
Na i sjellim cingaret me vete çdo ditë.
Çka sjellin ata me vete çdo ditë?
Ata i sjellin cingaret me vete çdo ditë.

A i nxjerr unë shpesh plaçkat nga rafti?
Po, ju i nxirni shpesh plaçkat nga rafti.
Çka nxjerr ti shpesh nga rafti?

Unë i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti.
Kush i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti?
Ai i nxjerr shpesh plaçkat nga rafti.
A i nxjerrim na çdo ditë librat nga syza?
Po, na i nxjerrim çdo ditë librat nga syza.
Kur i nxirni ju librat nga syza?
Na i nxjerrim çdo ditë librat nga syza.
Çka nxjerrin ata çdo ditë nga syza?
Ata i nxjerrin librat çdo ditë nga syza.

A ndiej unë ndonji dhimbë?
Jo, ju nuk ndieni ndonji dhimbë.
Çka nuk ndien ti?
Unë nuk ndiej ndonji dhimbë.
Kush nuk ndien ndonji dhimbë?
Ai nuk ndien ndonji dhimbë.
A ndiejmë na ndonji dhimbë?
Jo, na nuk ndiejmë ndonji dhimbë.
Çka nuk ndieni ju?
Na nuk ndiejmë ndonji dhimbë.
Cilët nuk ndiejnë ndonji dhimbë?
Ata nuk ndiejnë ndonji dhimbë.

A i djeg unë gazetat mbasi i lexoj?
Po, ju i digjni gazetat mbasi i lexoni.
Kur i djeg ti gazetat?
Unë i djeg gazetat mbasi i lexoj.
Kush i djeg gazetat mbasi i lexon?
Ai i djeg gazetat mbasi i lexon.
A i djegim na gazetat mbasi i lexojmë?
Po, na i djegim gazetat mbasi i lexojmë.
Kur i digjni ju gazetat?
Na i djegim gazetat mbasi i lexojmë.
Cilët i djegin gazetat mbasi i lexojnë?
Ata i djegin gazetat mbasi i lexojnë.

3. A ndoqa unë vjet nji shkollë rrobaqepsije?
Po, vjet ju ndoqët nji shkollë rrobaqepsije.
Çfarë shkolle ndoqe ti vjet?
Unë ndoqa vjet nji shkollë rrobaqepsije.
Kush ndoqi vjet nji shkollë rrobaqepsije?
Ai ndoqi vjet nji shkollë rrobaqepsije.
A ndoqëm na vjet nji shkollë rrobaqepsije?
Jo, na nuk ndoqëm vjet nji shkollë rrobaqepsije.

Çfarë shkolle nuk ndoqët ju vjet?
Na nuk ndoqëm vjet nji shkollë rrobaqepsije.
Cilët nuk ndoqën vjet nji shkollë rrobaqepsije?
Ata nuk ndoqën vjet nji shkollë rrobaqepsije.

A i hoqa unë pjatat nga tryeza?
Po, ju i hoqët pjatat nga tryeza.
Çka hoqe ti nga tryeza?
Unë i hoqa pjatat nga tryeza.
Kush i hoqi pjatat nga tryeza?
Ai i hoqi pjatat nga tryeza.
A i hoqëm na pjatat e gotat nga tryeza?
Po, na i hoqëm pjatat e gotat nga tryeza.
Çka hoqët ju nga tryeza?
Na i hoqëm pjatat e gotat nga tryeza.
Cilët i hoqën pjatat e gotat nga tryeza?
Ata i hoqën pjatat e gotat nga tryeza.

4. A e solla unë sot çantën me vete?
Po, ju e sollët sot çantën me vete.
Kur e solle ti çantën me vete?
Unë e solla sot çantën me vete.
Kush e solli sot çantën me vete?
Ai e solli sot çantën me vete.
A i sollëm na sot të gjithë librat me vete?
Jo, na nuk i sollëm sot të gjithë librat me vete.
Kur nuk i sollët të gjithë librat me vete?
Sot nuk i sollëm të gjithë librat me vete.
Cilët nuk i soliën sot të gjithë librat me vete?
Ata nuk i sollën sot të gjithë librat me vete.

A i nxora unë të gjitha karrigat nga dhoma?
Po, ju i nxorët të gjitha karrigat nga dhoma.
Çka nxore ti nga dhoma?
Unë i nxora të gjitha karrigat nga dhoma.
Kush i nxori të gjitha karrigat nga dhoma?
Ai i nxori të gjitha karrigat nga dhoma.
A i nxorëm na këpucët nga rafti?
Po, na i nxorëm këpucët nga rafti.
Prej nga i nxorët ju këpucët?
Na i nxorëm këpucët nga rafti.
Cilët i nxorën këpucët nga rafti?
Të gjithë i nxorën këpucët nga rafti.

A ndjeva unë dje nji dhimbë në shpatull?
Po, dje ju ndiet nji dhimbë në shpatull.
Kur ndjeve ti nji dhimbë në shpatull?
Dje unë ndjeva nji dhimbë në shpatull.
Kush ndjeu dje nji dhimbë në shpatull?
Ai ndjeu dje nji dhimbë në shpatull.
A ndiem na dje ndonji dhimbë?
Jo, na dje nuk diem ndonji dhimbë.
Çka nuk ndiet ju dje?
Dje na nuk ndiem ndonji dhimbë.
Cilët nuk ndien dje ndonji dhimbë?
Ata nuk ndien dje ndonji dhimbë.

5. A do të rrini në San Francisco deri të marten?
Po, do të rrij në San Francisco deri të marten?
Deri kur do të rrini në San Francisco?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.
Ku do të rrini deri të marten?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.
Çka do të bâni në San Francisco deri të marten?
Do të rrij në San Francisco deri të marten.

A do të rrini në klasë derisa të vîjë mësuesi?
Po, do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Ku do të rrini derisa të vîjë mësuesi?
Do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Kush do të rrijë në klasë derisa të vîjë mësuesi?
Unë do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.
Çka do të bâni derisa të vîjë mësuesi?
Do të rrij në klasë derisa të vîjë mësuesi.

A keni frikë kur jeni në dét vetëm?
Jo, nuk kam frikë kur jam në dét vetëm.
Kush nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm?
Ai nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm.
Kur nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë kur âsht në dét vetëm.

A keni frikë nga qent e mëdhaj?
Jo, unë nuk kam frikë nga qent e mëdhaj.
Kush nuk ka frikë nga qent e mëdhaj?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.
Nga çka nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.
Nga cilë qen nuk ka frikë ai?
Ai nuk ka frikë nga qent e mëdhaj.

A mbaj unë gjithëmonë me vete nji shamí?
Po, ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Kush mban gjithëmonë me vete nji shamí?
Ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Çka mbaj unë gjithëmonë me vete?
Ju mbani gjithëmonë me vete nji shamí.
Sa shamí mbani ju gjithëmonë me vete?
Unë mbaj gjithëmonë me vete nji shamí.

A ka njeriu 32 dhâmbë?
Po, njeriu ka 32 dhâmbë.
Sa dhâmbë ka njeriu?
Njeriu ka 32 dhâmbë.
Kush ka 32 dhâmbë?
Njeriu ka 32 dhâmbë.
A quhen dhëmballë 20 prej tyne?
Po, 20 prej tyne quhen dhëmballë.
Qysh quhen 20 prej tyne?
20 prej tyne quhen dhëmballë.

A ka shpella ndër male?
Po, ndër male ka shpella.
Ku ka shpella?
Ndër male ka shpella.
Çka ka ndër male?
Ndër male ka shpella.

A prishet koha shpesh në Monterey?
Po, në Monterey prishet koha shpesh.
Kur prishet koha në Monterey?
Në Monterey koha prishet shpesh.
Ku prishet koha shpesh?
Në Monterey koha prishet shpesh.

A i mbushni ju pjatat me gjellë?
Jo, unë nuk i mbush pjatat me gjellë.
Kush i mbush pjatat me gjellë?
Grueja i mbush pjatat me gjellë.
Çka mbush grueja me gjellë?
Grueja i mbush pjatat me gjellë?
Me çka i mbush grueja pjatat?
Grueja i mbush pjatat me gjellë.

6. A do t'i shpërlani rrobet mbasi t'i lani?
Po, mbasi t'i láj rrobet do t'i shpërláj.
Kush do t'i shpërlajë rrobet mbasi t'i lajë?
Ai do t'i shpërlajë rrobet mbasi t'i lajë.
Kur do t'i shpërlani rrobet?
Unë do t'i shpërláj rrobet mbasi t'i láj.

A ju pëlqen gjella me shumë krypë?
Jo, gjella me shumë krypë nuk më pëlqen.
Kujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë?
Kurrkujt nuk i pëlqen gjella me shumë krypë.
Qysh nuk ju pëlqen gjella?
Nuk më pëlqen gjella me shumë krypë.
A ju pëlqen gjella pa krypë?
Jo, gjella pa krypë nuk më pëlqen.
Kujt nuk i pëlqen gjella pa krypë?
Kurrkujt nuk i pëlqen gjella pa krypë.
Qysh nuk ju pëlqen gjella?
Nuk më pëlqen gjella pa krypë.

A e ndalni automobilin kur mrrîni në shtëpí?
Po, kur mrrîj në shtëpí e ndal automobilin.
Çka ndalni kur mrrîni në shtëpí?
Unë ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.
Kur e ndalni automobilin?
Unë e ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.
Çka bâni kur mrrîni në shtëpí?
Unë e ndal automobilin kur mrrîj në shtëpí.

A ka nevojtore kjo ndërtesë?
Po, kjo ndërtesë ka nevojtore.
Cila ndërtesë ka nevojtore?
Kjo ndërtesë ka nevojtore.
Çka ka kjo ndërtesë?
Kjo ndërtesë ka nevojtore.

A ju dhimti kamba dje?
Po, dje më dhimti kamba.
Kujt i dhimti kamba dje?
Mue më dhimti kamba dje.
Çka ju dhimti jú dje?
Mue më dhimti kamba dje.
Kur ju dhimti kamba?
Mue më dhimti kamba dje.

XXXXII

PJESA E PESTË
USHTRIME PËRKËTHIMI

FIFTH PART
TRANSLATION EXERCISE

1. Mbas disa ditësh do të shkoj me u-pâ me disa miq që kam në disa fshatra në rrethet e Vlonës. Ka vjetë që nuk kam shkue n'ato vende ku kam kalue nji kohë të gjatë kur ishem fëmijë. Rruga nga Vlona deri n'ata fshatra âsht nji rrugë e vjetër dhe âsht prishë krejt nga erënat, ujnat dhe shinat. Automobili shkon deri në gjymës të rrugës dhe mandej duhet t'udhëtoj më kambë. Nuk besoj të qëndroj atje mâ shumë se nji javë.
2. Jam mërzitë fort nga shëndeti (health) im i keq. Kohët e fundit dhâmbët më kanë dhimtë shpesh, kam pasë të ftofuna pa pushim e disa herë grip. Natyrisht, këto sëmundje më kanë mbajtë në shtrat për disa javë. Ilaçet dhe mjeku më kanë kushtue aq shumë që mos e pyet.

---

1. If you really think I am doing nothing good here, I will not stay any longer. What do you think, am I right?
2. Who taught your friend the Albanian language?

3. The tailor turned to his wife and told her to get out of the shop.
4. Why don't you phone your friend? Don't you believe he has the right to know about this matter.
5. Who picked out these apples? All of them are spoiled.
6. I cannot find the book you lent me. (Use the verb to give.)
7. My father drinks water with his meal.

XXXXII

PJESA E GJASHTË
COPË LEXIMI

SIXTH PART
READING TEXT

Proverb: Ku dhemb dhâmbi aty shkon gjuha.

Dje në mëngjes më dhimti shumë nji dhëmballë, prandej shkova ke dentisti. Posa hŷna sekretarja më tha me pritë pak mbasi dentisti ishte i zânun. Mbas pak kohe dentisti më ftoi në zyrën e tij. I tregova çka kishem dhe mbasi m'i shikoi dhâmbët, më tha se dhëmballa që më dhimte ishte prishë tepër e s'ishte e mundun me e mbushë, prandej më këshilloi me e nxjerrë.

Mbasi më bâni nji shiringë më nxori dhëmballën. Nuk ndjeva dhimbë. Mbasi filloi me rrjedhë gjak infermierja më dha nji gotë me ujë të krypun për të shpërlá gojën. Më tha të vazhdojshem me e bâ këtë gjâ edhe mbasi të shkojshem në shtëpí. Uji i krypun âsht shumë i mirë për të ndalë gjakun e për të pastrue gojën.

QUESTIONS - PYETJE

1. Kur më dhimti shumë nji dhëmballë?
2. Çka më dhimti shumë dje në mëngjes?
3. Ku shkova?

4. Kush më tha me pritë pak mbasi dentisti ishte i zânun?

5. Çka më tha sekretarja me bâ, posa hŷna?

6. Kush më ftoi në zyrën e tij mbas pak kohe?

7. Ku më ftoi dentisti mbas pak kohe?

8. Kush i tregoi dentistit çka kishem?

9. Kush m'i shikoi dhâmbët?

10. Cila dhëmballë ishte prishë tepër?

11. Çka s'ishte e mundun me bâ?

12. Kê këshilloi dentisti me e nxjerrë?

13. Sa shiringa më bâni dentisti?

14. Çka më nxori mandej?

15. Kush nuk ndjeu dhimbë?

16. Çka filloi me rrjedhë?

17. Kush më dha nji gotë me ujë të krypun?

18. Pse më dha infermierja nji gotë me ujë të krypun?

19. Çka më tha infermierja të vazhdojshem me bâ?

20. Kur do të vazhdojshem me e bâ këtë gjâ?

21. Kush më tha të vazhdojshem me e bâ këtë gjâ edhe mbasi të shkojshem në shtëpí?

22. Për çka âsht shumë i mirë uji i krypun?

23. Çka âsht shumë i mirë për të ndalë gjakun e për të pastrue gojën?

XXXXII

PJESA E SHTATË
DETYRË SHTËPIJE

SEVENTH PART
HOMEWORK

Translate into English:

1. Ai dogji gishtin tue ndezë cingaren.
2. Pse nuk e hiqni xhaketën?
3. Kemi ecë gjatë bregut të detit deri afër skeles.
4. Foli më mue derisa erdhi koha me u-nisë.
5. Duhani nuk sjell asnji dobi.

Answer the following questions in Albanian:

1. Kush ka frikë mâ shumë: qeni nga maca, apo maca nga qeni?
2. Cilave gjâna që hamë nuk u shtijmë krypë?
3. Ku shkoni kur keni dhimbë dhâmbësh?
4. Çka i ngjân automobilit në qoftë se nuk i shtini voj?
5. Në çë rasë duhet t'a hiqni kapelën?

dentist, -i dentista, -t	(m.)	dentist
derisa	(conj.)	until
me djegë (unë djeg)	(v.)	to burn, sting
dobí, -ja dobí, -t	(f.)	benefit, use, profit, advantage, utility
dhëmballë, -a dhëmballë, -t	(f.)	molar
frikë, -a	(f.)	fear
gjak, -u gjaqe, -t	(m.)	blood, vengeance
me hjekë (unë hjek)	(v.)	to draw, take away, take off, remove; suffer
krypë, -a krypna, -t	(f.)	salt
i, e, të krypun të krypuna	(adj. m.&f.)	salted
me mbushë (unë mbush)	(v.)	to fill, complete (time)
menjiherë	(adv.)	immediately
mish i dhâmbëvet	(m.)	gum
me ndalë (unë ndal)	(v.)	to stop
me ndie (unë ndiej)	(v.)	feel, hear

nevojtore, nevojtorja nevojtore, -t	(f.)	restroom, lavatory
me nxjerrë (unë nxjerr)	(v.)	to get out, put out, take out, bring out, draw out
prandej	(conj.)	therefore, so
me u-prishë (unë prishem)	(v.)	to be broken, destroyed, ruined, erased; be spent (money by waste); be changed (money)
me provue (unë provoj)	(v.)	to prove, try, test,
me rrjedhë (unë rrjedh)	(v.)	to flow, run, derive, leak, to come from, originate
shamí, -ja shamí, -t	(f.)	handkerchief
shiringë, -a shiringa, -t	(f.)	injection
shpellë, -a shpella, -t	(f.)	cave
me shpërlá (unë shpërláj)	(v.)	to rinse
me shtí (unë shtij)	(v.)	to put in, insert; shoot
vrimë, -a vrima, -t	(f.)	hole

NOTES:

...që mos e pyet	...and how! Surely!
besa po	in truth, indeed, well yes
me pasë frikë (unë kam frikë)	to be afraid
ngjân	happens

PJESA E PARË
USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. (a.)
A âsht e nevojshme me e lá automobilin shpesh?
Po, âsht e nevojshme me e lá automobilin shpesh.

A shkoni ju shpesh me u-lá në dét?
Po, unë shkoj shpesh me u-lá në dét.

A e lani ju shpesh automobilin?
Po, unë e láj shpesh automobilin.

A laheni ju shpesh në dét?
Po, unë lahem shpesh në dét.
Kush lahet shpesh në dét?
Unë lahem shpesh në dét. (ti, ai etj.)

A do të laheni nesër në dét?
Po, unë do të lahem nesër në dét.
Kush do të lahet nesër në dét?
Unë do të lahem nesër në dét. (ti, ai etj.)

A e latë automobilin dje?
Po, e lava?
Kush e lau automobilin dje?
Unë e lava automobilin dje. (ti, ai etj.)

A u-latë dje në dét?
Po, unë u-lava dje në dét.
Kush u-lá dje në dét?
Unë u-lava dje në dét. (ti, ai etj.)

A e keni lá ndonjiherë automobilin me sapun?
Po, unë e kam lá shpeshherë automobilin me sapun.
Kush e ka lá automobilin me sapun?
Unë e kam lá automobilin me sapun. (ti, ai etj.)

A jeni lá ndonjiherë në dét?
Po, unë jam lá shpesh në dét.
Kush âsht lá shpesh në dét?
Unë jam lá shpesh në dét. (ti, ai etj.)

(b.)
Kur shkoni nëpër qytet, a duhet me e ndalë shpesh automobilin?
Po, kur shkoj nëpër qytet duhet me e ndalë shpesh automobilin.

A ju pëlqen me u-ndalë shpesh?
Jo, nuk më pëlqen me u-ndalë shpesh.

A e ndalni ju shpesh automobilin në qytet?
Po, unë e ndal shpesh automobilin në qytet.
Kush e ndal shpesh automobilin në qytet?
Unë e ndal shpesh automobilin në qytet. (ti, ai etj.)

A ndaleni ju shpesh në qytet?
Po, unë ndalem shpesh në qytet.
Kush ndalet shpesh në qytet?
Unë ndalem shpesh në qytet. (ti, ai etj.)

A do të ndaleni nesër në qytet?
Po, unë do të ndalem nesër në qytet.
Kush do të ndalet nesër në qytet?
Unë do të ndalem nesër në qytet. (ti, ai etj.)

A e ndalët automobilin dje para shtëpís sime?
Po, dje e ndala automobilin para shtëpís suej.
Kush e ndali automobilin dje para shtëpís sime?
Unë e ndala automobilin dje para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A u-ndalët dje para shtëpís sime?
Po, unë u-ndala para shtëpís suej.
Kush u-ndal para shtëpís sime?
Unë u-ndala para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A e keni ndalë ndonjiherë automobilin para shtëpís sime?
Po, e kam ndalë.
Kush e ka ndalë automobilin para shtëpís sime?
Unë e kam ndalë automobilin para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

A jeni ndalë ju para shtëpís sime?
Po, unë jam ndalë para shtëpís suej.
Kush âsht ndalë para shtëpís sime?
Unë jam ndalë para shtëpís suej. (ti, ai etj.)

2. (a.)
A lahem unë mbasi rruhem?
Po, ti lahe mbasi rruhe.
Kush lahet mbasi rruhet?
Ti lahe mbasi rruhe. (ai. na etj.)

(b.)
A vizitohem unë shpesh ke mjeku?
Po, ti vizitohe shpesh ke mjeku.
Kush vizitohet shpesh ke mjeku?
Ti vizitohe shpesh ke mjeku. (ai, na etj.)

(c.)
A takohet ai me mue në kafe?
Po, ai takohet me jú në kafe.
Kush takohet me mue në kafe?
Ai takohet me jú në kafe.

A takohemi na shpesh në kafe?
Po, na takohemi shpesh në kafe.
Cilët takohen shpesh në kafe?
